



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 786/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr. 424/16, dt. 24.07.20016 e BPrAL Kolegji "Gjilani" për riakreditim të programeve të studimit:
  - Juridik Penal, LLM, 60 ECTS;
  - Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "Gjilani" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimeve: Juridik Penal/ LLM dhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze/ BA. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 25 gusht 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Gjilani" bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike kërkohet që institucioni i arsimit të lartë të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi. Pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.02/2013, datë: 16.01.2013, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion, përkatësisht BPrAL Kolegji "Gjilani" ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për programet e studimit dhe nuk përmbush kushtet formale për aprovim. Rrjedhimisht KSHC ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji "Gjilani" për programet e mësipërme të studimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Gjilani";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë